



# Zëri i Grave Kosovare

Përkrahë, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Nëntor 2012



*Më shumë se 1,000 qytetarë marshojnë dhe rreth 5,700 nënshkruajnë peticionin për "Drejtësi dhe dinjitet para negociatave". Protestuesit dorëzuan kërkesat e tyre për drejtësi në prapunë dhe derës së Qeverisë dhe në duar të zyrtarëve ndërkombëtarë.*

Në këtë botim

[Gratë, vajzat të pakënaqura me buxhetin për vitin 2013](#)

[Qeveria zotohet për buxhetim që merr parasysh nevojat gjinore](#)

[RRGGK mirëpret anëtarin e 100-të të Organizatës](#)

[Grupet avokuese për barazi gjinore fuqizojnë gratë](#)

[Diversiteti, solidariteti dhe aktivizmi e përbëjnë lëvizjen e grave](#)

[RrGGK Mobilizon vajzat aktiviste](#)

Këtë sezonë pushimesh:  
Përkrah të drejtat e grave!

Miq, na vjen mirë që po shpallim një mundësi të re për të kontribuar në përpjekjet e RrGGK-së për të punuar për të drejtat e grave dhe vajzave! Tash mund të bëni donacione (që hiqen nga taksat në ShBA), falë partnerëve tanë Institutit për Menaxhim Lindje-Perëndim. Na dërgoni email në [info@womensnetwork.org](mailto:info@womensnetwork.org) për më shumë informata!

## Qytetarët protestojnë për drejtësi e dinjitet; 5,700 nënshkruajnë peticionin

Rreth 1,000 njerëz morën pjesë në protestën "Drejtësi dhe dinjitet para negociatave," organizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGGK) dhe *Thirrjet e Nënave*. Prej atëherë, rreth 5,700 njerëz kanë nënshkruar peticionin me të njëjtat kërkesa si ato që i kanë bërë protestuesit: kërkimfalje nga Serbia për krimet e kryera në Kosovë gjatë 1990-ave, kthimin e personave të pagjetur, drejtësi për shkeljen e të drejtave dhe kompensim për dëmet morale dhe ekonomike.

"Për pa i përbush këto kërkesa, çfarëdo lloj negociimi me Serbinë është i papranueshëm. Këto janë kërkesa lëgjitime të një populli ndaj të cilit është kryer gjenocid," tha Nysrete Kumnova nga *Thirrjet e Nënave* gjatë fjalimit të saj në protestë.

Protestuesit kërkuan që këto kërkesa të plotësohen para se liderët kosovarë të ulen në tavolinë për të biseduar me zyrtarët serbë. Protesta u zhvillua në kontekstin e negociatave të sapo shpallura mes Kosovës dhe Serbisë.

"Duhet t'ia përkujtojmë Serbisë se na kanë borxh," brohoriti gjatë protestës nga podiumi drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së, Igballe Rogova. "Drejtësia tranzicionale nuk arrihet vetëm përmes negociatave. Janë disa kushte që po i kërkojmë: Kërkimfalje dhe drejtësi për krimet e luftës."

"Së bashku kemi kërkuar drejtësi, dhe dinjitet, si nga qeveria ashtu edhe nga institucionet ndërkombëtare," tha Selatin Kaçaniku, protestues. "Për sa kohë që Serbia mbetet e pabindur për atë që ka bërë, përderisa nuk e pranon publikisht, nuk kemi kurrfarë arsye për të biseduar me ta," tha ai.

Gjatë protestës paqësore, pjesëmarrësit ishin veshur në ngjyrë të kuqe për të simbolizuar gjakun e viktimave të vrara nga lidhshipi kriminel i Serbisë gjatë gjenocidit të viteve 1997-1999 në Kosovë. Në fund të protestës, pjesëmarrësit vunë një baner me kërkesat e tyre në prapunë e derës së Qeverisë. RrGGK dhe *Thirrjet e Nënave* i dërguan letra me këto kërkesa edhe Sekretares së Shtetit të ShBA-ve, Hillary Rodham Clinton, Shefes për Politikë të Jashtme të BE-së Catherine Ashton, Raportueses për Kosovë të Parlamentit Europian - Ulrike Lunacek, Presidentes së Kosovës - Atifete Jahjaga dhe Kryeministrit Hashim Thaci.



*Një burrë duke treguar respekt për nënat e personave të pagjetur gjatë demonstratës me 19 nëntor. Dikund rreth 1.756 persona janë ende të pa ajetur.*

Bashkohuni!



[Me ne në Facebook.](#)

[Me grupin tonë në Facebook](#)



[Me listën tonë të E-Lajmeve](#)

Përafërisht 5,700 njerëz nga mbarë bota, përfshirë edhe Sërbinë, kanë nëshkruar peticionin me të njëjtat kërkesa. [Lidhja ndërkombëtare e grave për paqe dhe liri](#) (LNGPL), Gratë në të zeza në Serbi, Sindikata e Punëtorëve (BSPK), OJQ "Konsumatori", Klubi Politik i Studentëve, Instituti Kosovar për Hulumtime Politikash dhe Zhvillim (KIPRED), Nisma për Progres, Vita-Jeta, IPKO Hej, Handikos, Konsortiumi i Shoqërisë Civile Kosovare për Zhvillim të

Qëndrueshëm dhe Lëvizja Vetëvendosje po ashtu janë pajtuar me kërkesat tona. "Këto nuk janë aq kërkesa të mëdha," tha Fëllanza Berisha, një tjetër protestuese. "Janë prej ma modesteve dhe ma të drejtave ... por vetëm për ata që kanë veshë e shpirt."



*Gratë në të Zeza në Serbi mbështesin kërkesat e kosovarëve për drejtësi gjatë protestës së tyre në Beograd në nëntor.*

## Gratë, vajzat të pakënaqura me Buxhetin 2013 të Republikës së Kosovës

Pas leximit të parë të buxhetit në Kuvendin e Kosovës, RrGGK lëshoi një [deklaratë](#), që iu dërgua të gjithë parlamentarëve, zyrtarëve kyç të qeverisë dhe mediave, që thotë:

"Ne, si qytetare të Republikës të Kosovës, jemi krejtësisht kundër kalimit në leximin e parë të Buxhetit të Kosovës për 2013-ën nga Qeveria dhe Parlamenti. Nuk pajtohem me mënyrat në të cilat zyrtarët tanë të **zgjedhur** kanë vendosë t'i shpenzojnë paratë e tatimeve **tona**. Besojmë se ky buxhet nuk pasqyron interesat kryesore të qytetarëve të Kosovës. Përveç kësaj, buxheti nuk i plotëson as për së afërmi nevojat specifike të grave e vajzave, përkundër faktit se Ministria e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, Lila-Kusari, është zotuar publikisht për buxhetim që do i përgjigjej nevojave gjinore.

Jemi thellësisht të shqetësuar që shpenzimet kapitale përbëjnë **41%** të buxhetit qendror të Kosovës. A na duhen edhe më shumë ndërtesa qeveritare? Çka përfiton një qytetar i Kosovës nga Shtëpia e Bardhë prej 1 milion eurove për Presidencën? Pos kësaj, jemi të tmerruar për shkak se më shumë se **22%** e buxhetit tonë janë nda për rrugë (€267,700,000). A janë rrugët më të rëndësishme se mirëqenia e Kosovarëve? Si do të kontribuojnë këto investime në zhvillimin njerëzor - si të grave ashtu edhe të burrave? Besojmë se nuk janë vlerësuar në mënyrë adekuate implikimet e këtyre investimeve në zhvillimin njerëzor afatshkurtë dhe afatgjatë.

*"Na tmerron fakti se më shumë se 22% e buxhetit tonë është ndarë për rrugë."*

Në anën tjetër, sipas propozim-buxhetit mbesin të keqfinancuara fushat që kanë potencial të mirëfilltë për të bërë investime në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale për shumë kosovarë që mundohen të jetojnë e punojnë në zonat rurale

(p.sh. nga buxheti i Ministrisë të Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural prej €23,359,230; Departamentit të Zhvillimit Rural i janë nda €109,050).


E dimë se arsimiti si fushë parësore krijon mundësi për të siguruar që kosovarët të garojnë për vende pune në tregjet lokale dhe globale (p.sh. mundësonë krijimin e remitancave të vazhdueshme nga të cilat mbijetojnë shumë kosovarë), mirëpo nuk besojmë se qeveria ka planifikuar të investojë sa duhet për të ofruar mundësi për arsim *cilësor*. Gjysma e buxhetit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë prej €44,679,592 do të shpenzohet në shpenzime kapitale (€22,650,000), gjë që jo domosdo e ngritë *cilësinë* e arsimit që ofrohet.

Shpenzimet e lidhura me rendin e ligjin përfshijnë vetëm 10% nga buxheti qendror për 2013-ën, duke e rrezikuar kështu aftësinë e policisë dhe gjyqësorit për të siguruar rend e ligj. Ky planifikim do të anashkaloj gjithësi nevojën për zhvillimin njerëzor dhe mirëqenien sociale. Shëndetësia merr vetëm 8.85% të buxhetit, ndërsa Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale 18.4%.

Planifikimi buxhetor i paraparë nuk ndanë mjete të mjaftueshme për programe kyçe drejt përmirësimit të mirëqenies së grave e vajzave, si dhe të qytetarëve në përgjithësi. Agjencioni për Barazi Gjinore, me €185,770, nuk do të arrij të mbuloj nevojat dhe programet e planifikuara, e që gjithësi do të ketë ndikim në mundësinë e këtij agjencioni për të siguruar se barazia gjinore është bërë pjesë kyçe e zhvillimit e të gjitha niveleve në Kosovë, në pajtim me Ligjin për Barazi Gjinore. Ligjet dhe programet tjera për barazinë gjinore, përfshi Programin dhe planin e veprimit kosovar kundër dhunës në familje, janë lënë të pa adresuara sikurse në 2012-ën, përkundër rekomandimeve që, përveç tjerëve, i ka bërë edhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës.

*"Ligjet dhe programet për barazi gjinore ... janë po aq të keqfinancuara si në 2012."*

## Shpenzimet e Pritura të Buxhetit Qendrorë të Kosovës 2013



Si përfundim, besojmë se ky buxhet nuk i adreson mjaftueshëm prioritetet e Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve, që është zotuar për zhvillim ekonomik, rend e ligj, zhvillim njerëzor dhe mirëqenie sociale. Apelojmë tek ju që menjëherë të ndërmerrni veprime për ta rishikuar dhe përmirësuar buxhetin e vitit 2013 ashtu që të adresohen më mirë nevojat e mirëfillta e prioritare të grave e burrave në Kosovë, pra ato që mundësojnë zhvillim njerëzor – e jo vetëm të atyre që mundësojnë projekte personale të disa zyrtarëve qeveritarë.

### Qeveria zotohet për buxhetim që mbulon nevojat gjinore; Aktivistet kërkojnë veprim

Zëvendës kryeministrja dhe Ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Mimoza Kusari-Lila, mes tjerësh zyrtarë qeveritarë, premtoi që të çoj tutje buxhetimin që përmbush nevojat gjinore në Kosovë gjatë një konference mbi "Buxhetimin për nevojat gjinore: Praktikat dhe sfidat," organizuar nga Agjencioni për Barazi Gjinore (ABGj) në Prishtinë më 15 nëntor.

"Jam e përkushtuar edhe si qytetare e Kosovës edhe si Ministre," tha Kusari-Lila. "Do të bëjmë krejt çka është e mundur për të implementuar buxhetimin për nevojat gjinore në praktikën tonë ditore." Zotimi i saj shkoi aq larg, sa që u largua fshehtëzi nga salla para takimit të parë plenar. Ajo mungoi kur u shkëmbyen praktikat më të mira ndërkombëtare, si dhe diskutimet mbi rrugën që e pret Kosovën. Po të kishte qëndruar, do t'i ndëgjonte brengat dhe sfidat kryesore që u dhanë nga përfaqësuesja e RrGGK-së gjatë diskutimit post-plenar:

*"Me folë për buxhetimin për nevojat gjinore është diçka. Krejt tjetërçka është me e zbatu në praktikë."*

- o **Buxhetimi për nevojat gjinore në Kosovë nuk është prioritet.** Korniza afatmesme e shpenzimeve (KASH), në teori zotohet për prioritetet si rendi e ligji, zhvillimi njerëzor dhe mirëqenia sociale. Mirëpo, në praktikë, në buxhetin e vitit 2012 investimet kapitale përbënin më shumë se 60% të shpenzimeve. KASH-i parasheh fokusim të vazhdueshëm në investimet kapitale deri në 2014-ën, që paraqet pengesë për buxhetimin kah nevojat gjinore. Ndoshta duhet të ketë auditim gjinor nga ABGj mbi atë se si kanë ndiku ndryshe zgjedhjet e financimit në KASH mbi gratë dhe burrat.
- o Tash kur Kuvendi i Kosovës është duke e miratuar buxhetin për vitin 2013, RrGGK pyet **nëse ABGj ka kryer auditimin gjinor** të kësaj politike qeveritare (si i takon simbas përgjegjësisë të ABGj-së nën Ligjin për Barazi Gjinore). Nëse po, a e ka marrë parasysh qeveria ndonjë rekomandim të ABGj-së kur e ka hartuar buxhetin e ri?
- o Strategjitë dhe planet shtetërore në Kosovë, si p.sh. për barazi gjinore ose mbrojtje nga dhuna në familje, nuk kanë linja të qarta buxhetore të ndara për institucione specifike. Strategjitë e ardhshme qeveritare duhet të identifikojnë më mirë se **cili institucion është përgjegjës për alokimin e buxhetit dhe shumën e buxhetit që kërkohet**, me synim implementimin.
- o Kosovës i duhen të dhëna më të mira, sidomos **analiza gjinore të buxhetit që informojnë vendimet buxhetore.** Nevojitet, jo vetëm thjesht mbledhja e të dhënave, por edhe analizë e hollësishme e asaj se si ndikojnë vendimet buxhetore ndryshe në gratë dhe në burrat. ABGj dhe zyrtarët për barazi gjinore në ministri e në komuna luajnë rol të rëndësishëm për t'u siguruar që vendimet buxhetore në të ardhmen të ndikohen nga analizat.
- o **Qarkorja buxhetore nuk e sqaron si duhet se si do të përfshihen ABGj dhe zyrtarët për barazi gjinore në ministri e komuna në procesin e buxhetit.** Roli i tyre duhet të bëhet i qartë dhe i detyrueshëm gjatë procesit. Përgjegjësitë e tyre duhet të specifikohen në përkrahjet e detyrave të tyre të punës dhe ABGj duhet të jep udhëzime mbi atë se çka duhet të kërkohet dhe shqyrtohet gjatë vlerësimit të kapacitetit gjinor të draft buxheteve.

Këto gjetje dhe rekomandime janë bazuar në [hulumtimin](#) e bërë rishtazi nga RrGGK mbi këtë temë. Ekspertë nga Gjermania, Suedia dhe Shqipëria po ashtu kanë ndarë praktikat më të mira në buxhetimin gjinor nga vendet e tyre.

"Barazia gjinore dhe zhvillimi ekonomik shkojnë dorë për dorë" tha Catharina Schmitz, drejtoreshë e Indevalop nga Suedia. Pagat e barabarta kanë ndikim pozitiv në BPK. Caktimi i synimeve specifike kah barazia gjinore është i rëndësishëm, tha ajo, dhe në Suedi buxhetimi kah nevojat gjinore ka katër qëllime:

- 1) Gratë nuk kanë **qasje të barabartë në pushtet** si qytetare aktive në shoqëri;



- 2) **Barazia ekonomike:** gratë dhe burrat kanë mundësi të barabarta për punë të paguara dhe pavarësi ekonomike. Këtu Suedia më shumë merret me individë sesa me grupe;
- 3) **Shprëndarje e barabartë e punës në shtëpi:** kompensimi i pabarabartë për punën që kryhet në shtëpi është faktor që përcakton pse gratë fitojnë mesatarisht më pak sesa meshkujt. Balansimi i punës në shtëpi iu mundëson grave që të punojnë jashtë shtëpisë dhe të fitojnë më shumë; dhe
- 4) **T'i jepet fund dhunës që e bëjnë meshkujt ndaj grave.**

Ajo theksoi nevojën për analizë të të dhënave, sidomos të programeve të sektorit dhe ofrimit të shërbimeve, për të analizuar se kush përfiton nga programet shtetërore dhe ndikimin e alokimeve nga financimi shtetëror. Vlerësimi i ndikimit është i rëndësishëm për vlerësimin e buxhetit dhe marrjen e vendimeve buxhetore. Për shembull, Suedia po merret me atë nëse programet shtetërore në fakt zvogëlojnë pabarazinë; pse gratë rrinë më shumë sëmure në shtëpi sesa burrat; si mund të përkrahin zvogëlimet në tatime njerëzit që paguhen dobët, përfshirë gratë; dhe auditimi i komisioneve parlamentare propozoi reforma politikash nga prizmi gjinor. Suedia, poashtu, ka ndarë një fond për komunat për të pilotuar nismat për buxhetimin gjinor.

Bazuar në përvojën gjermane, fakti se ABGj gjendet në Zyren e Kryeministrit është i rëndësishëm për inkorporimin e buxhetimit gjinor prej 'majës-poshtë'. Në Gjermani, buxheti gjinor konsiderohet qenësor për procesin e buxhetit, dhe të gjithë zyrtarët financiarë janë të përfshirë në buxhetimin gjinor. Politikat shpesh me praktikën më të mira kanë tentuar që të avancojnë barazinë gjinore duke i integruar burrat në qendrat e kujdesit prindëror dhe në role tjera që tradicionalisht mbahen nga gratë, duke i prezentuar rinisë role pozitive të grave dhe burrave; duke nisur stimulime për ta ulë papunësinë mes grave; dhe duke kërkuar zbatim standardesh specifike nga zyrtarët për barazi gjinore.

*"Buxheti gjinor është e drejtë për burrat dhe gratë."*

- Klaus Feiler, Sekretar shteti, Senat Finance

Edhe pse ka mbetë prapa vendeve tjera europiane, Shqipëria ka zbatuar disa politika për të siguruar barazi gjinore mes grave dhe burrave, si dhe për ta avancuar barazinë ekonomike të grave, tha Alida Tota nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta në Shqipëri.

## **RrGGK mirëpret organizatën e 100-të anëtare: "Prehja"**

RrGGK mirëpriti organizatën e 100-të anëtare: "Prehja" nga Skenderaj, në tetor të vitit 2012. Prej se është themeluar në vitin 2000, RrGGK është rritur nga 36 anëtarë, sa i ka pasë në fillim. RrGGK shënoi këtë moment të rëndësishëm me dhurimin e një kompjuteri për anëtarin më të ri. "Prehja" punon aktivisht për të ngritë vetëdijen dhe për t'i fuqizuar gratë.

RrGGK është lider në mesin e organizatave të shoqërisë civile në Kosovë e në rajon, dhe përfaqëson interesat e organizatave të grave të të gjitha grupeve etnike anembanë Kosova. Prej fillimit të vet, RrGGK ka mbajtur takime të rregullta të anëtarëve, punëtori dhe aktivitete që përfshinin anëtarët e vet. Ata informohen për aktivitetet e RrGGK-së, për mundësitë për t'i zhvilluar kapacitetet e tyre dhe për mundësitë e financimit. 100 anëtarët e organizatës tonë kanë mundësinë që të takohen shumë herë gjatë vitit, të ndajnë idetë, të mësojnë strategji të reja dhe të nisin punë të përbashkëta. Në vitin 2006, RrGGK u bë rrjeti i parë i organizatave jo-fitimprurëse, joqeveritare, në Kosovë që ka miratuar kodin e sjelljes, duke dhënë shembull të transparencës dhe përgjegjësisë.



*Ajnishahe Halimi nga Prehja pranon një kompjuter si Anëtarja e 100-të e RrGGK-së.*

## **Grupet e avokimit të barazisë gjinore fuqizojnë gratë, avancojnë barazinë gjinore lokalisht**

Tetë grupe avokimi për barazi gjinore (GABGj) po ndër marrin veprime të rëndësishme për ta avancuar barazinë gjinore në mesin e komunave të tyre, falë përkrahjes nga RrGGK. GABGj-të përbëhen nga deputete gra të kuvendeve komunale, gratë në shoqërinë civile, zyrtarët komunalë për barazi gjinore dhe të tjerë që synojnë ta avancojnë barazinë gjinore në nivelin komunal, përfshi edhe burrat. GABGj-të kanë marrë përkrahje edhe nga kryetarët e komunave.

Krejt kishte nisur me vizitat e RrGGK, grave që janë përfshi në politikë dhe në shoqërinë civile në këto komuna, duke kërkuar që t'i bindin ato se as RrGGK e as ato nuk do të mund të arrijnë shumë për pa punuar së bashku. Të arriturat e deri tashme që rezultojnë nga bashkëpunimi pozitiv mes grave parlamentare dhe RrGGK ilustrojnë se si bashkëpunimi mes sektorëve mund të rezultojë i suksesshëm edhe në nivelin komunal.

"Shembull i këtij bashkëpunimi në nivelin qendror dhe shembull i mirë i avokimit, është protesta, 'Nuk duam lule. Duam drejtësi!' më 8 mars 2012," tha drejtoresha ekzekutive e RrGGK, Igballe Rogova. "Menjëherë të nesërmen, çështja e dhunimit të grave gjatë luftës u ngrit për herë të parë në Parlamentin e Kosovës nga gratë parlamentare."

Vizitat nëpër komuna për ta mundësuar bashkëpunimin kërkonin shumë kohë dhe punë, sipas Igballe Rogovës, por dikur gratë u bindën se bashkëpunimi do të arrinte rezultate më të mira se puna e pavarur. Tash GABGj-të janë themeluar në tetë komuna: Novo Bërdë, Dragash, Prizren, Shtime, Gjakovë, Mamushë, Gjilan dhe Mitrovicë. GABGj synojnë që të arrijnë barazinë gjinore, sidomos duke i fuqizuar gratë në politikë dhe duke i adresuar çështjet tjera me të cilat ballafaqohen gratë në komunat e tyre.

Për shembull, në Dragash, GABGj ka avokuar me sukses për transportin publik. Paraprakisht, mungesa e transportit kryesisht ndikonte në gratë që nuk mund të udhëtonin pasi që nuk kishin vetura. Kur GABGj ia bëri me dije këtë Kryetarit të Komunës së Dragasht, ai menjëherë ndër morri veprime për ta adresuar këtë çështje. Ky GABGj tash po avokon për themelimin e çerdhes që do t'i fuqizonte nënat që punojnë.

GABGj i kanë ofruar grave në politikë përkrahje nga gratë tjera në politikë dhe nga shoqëria civile nga komunat e tyre, si dhe nga GABGj në komunat tjera. Si rezultat i kësaj, gratë tash nuk ndihen të vetmuara kur ballafaqohen me diskriminimin gjinor brenda partive të tyre dhe/ose gjatë vendim-marrjes në komuna.



*Vizita e frave parlamentare me Grupet e Avokimit të Barazisë Gjinore nga Dragashi, Mamusha dhe Prizreni, shkëmbimi i përvojave dhe strategjia për të çuar përpara të drejtat e grave.*

"Më keni bërë të fortë," i tha një grua deputete komunale RrGGK-së. "Deri tash jam ndi shumë e vetmuar. Megjithatë, tash kur ngrit një çështje për dikutim në punë, ndihem sikur të gjitha gratë [GABGj-të] janë prapa meje."

Në të njejtën kohë, GABGJ-të i kanë ofruar grave në shoqërinë civile çasje më të lehtë që t'u dëgjohen zërat brenda kuvendeve komunale, duke mundësuar avokimin për avancimin e të drejtave të grave lokalisht.

"Për mua, pjesa më e bukur e këtij aktiviteti, dhe sukcesi më i madh është se është krijuar solidaritet mes grave. Puna e koha që kërkohen për t'i bindë gratë për të bashkëpunuar është shpëguar," reflektoi Igballe Rogova, që e ka udhëheqë këtë nismë. "Tash komunat që ende nuk i kanë themeluar këto grupe kanë ndëgjuar për GABGj nga tjerët, dhe ato vullnetarisht dojnë me nis kësaj iniciativë në fushat e tyre."

Bazuar në kërkesat e tyre, në vitin 2013 RrGGK planifikon që të mbështesë themelimin e GABGJ-ve në pesë komuna të reja: Podujevë, Deçan, Viti, Drenas dhe Suharekë, të përkrahura nga Agjencioni Austriak për Zhvillim. Më 2011 dhe 2012, Ambasada e Mbretërisë së Holandës më mirësi ka përkrahur punën e RrGGKsë për t'i fuqizuar GABGj-të.

## Reflektime mbi 20 vjetorin e organizimit të grave në 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë: diversiteti, solidariteti dhe aktivizmi përbëjnë lëvizjen e grave

Në mesin e festimeve për ta shënuar 100 vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, shoqatat shqiptare "Në favor të grave shqiptare", OJQ "Reflektime" dhe "Qendra e aleancës gjinore për zhvillim" organizuan një varg aktivitetesh me moton "100 vjet të grave që kanë jetuar dhe kontribuar për Shqipërinë." Këto aktivitete shënuan 20 vjetorin e aktivizmit të grave në kontekstin e ndryshimeve politike në Shqipëri.

Konferenca "90 + 20, Lëvizja e grave në Shqipëri – Rruga përpara" ishte e para në vargun e aktiviteteve që u organizuan në nëntor. Përveç historisë dhe kontributeve të grave në avansimin e shoqërisë shqiptare, në konferencë u diskutuan mësimet e nxëna dhe strategjitë për rrugën përpara. Drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së, Igballe Rogova bëri përmbylljen e konferencës, duke i identifikuar parimet kryesore që nevojiten për ta mbajtur gjallë një lëvizje të grave:

1. **Diversiteti:** Ne gratë jemi të ndryshme, por bashkohemi dhe bëhemi një për një qëllim. Nëse nuk i pranojmë dallimet tona, atëherë nuk mund të ketë lëvizje;
2. **Solidariteti:** Pavarësisht rrethanave, ne gratë duhet të bashkëpunojmë sepse luftojmë për çështje të përbashkëta. Duhet t'i shmangemi rasteve kur gratë sulmojnë gratë. Duhet të përkrahim njëra tjetrën për t'i arritur qëllimet; dhe
3. **Aktivizmi:** Lëvizja nuk mund të gjallnojë pa këtë element. Aktivizmi duhet të shprehet në rrugë, me deklarata ose me mënyra tjera. Që lëvizja të gjallnojë, duhet të jetë e dukshme.



*Siluetat e grave të rëndësishme të histories së Shqipërisë qëndrojnë para muzeut në Tiranë.*

Pas konferencës, pjesëmarrëset morën pjesë në ekspozitën "100 vjet të jetës dhe kontributeve të grave në Shqipëri." Siluetat e grave të rëndësishme për historinë e Shqipërisë qëndronin në hyrjen e muzeut në Tiranë. Hulumtimet në arkivat e historisë u morën parasysh në këtë përzgjedhje. 100 vjetori i Shqipërisë dhe aktivizmi 20 vjetor i grave në Shqipëri u shënuan me orë letrare, panele diskutimesh dhe shfaqje të dokumentarëve, "Gratë bëjnë historinë" në disa stacione televizive në Shqipëri. Aktivitetet u përmbyllën me një edicion komplet që shënon figurat më të rëndësishme të grave, të titulluar, "90 + 20, Lëvizja e grave në Shqipëri – Rruga përpara."

## RrGGK mobilizon vajzat aktiviste në Prizren dhe Gjiilan

Udhëheqëset e lëvizjeve të grave, përfshi edhe ato në Kosovë, po plaken, dhe kjo nganjëherë ka parandaluar përfshirjen e vajzave në lëvizje. Organizatat anëtare të RrGGK i kanë identifikuar këto si çështje kyçe me të cilat ballafaqohet qëndrueshmëria e organizatave të grave në Kosovë. Për këtë arsye, RrGGK është ka filluar një nismë të re për të

përfshirë më shumë vajza në lëvizjen e grave të Kosovës. Për këtë qëllim, RrGGK i ka mbajtur dy takimet e para me vajzat, që duan të jenë aktiviste në tetor 2012 në Prizren dhe në nëntor 2012 në Gjilan.

Përmes këtyre dhe takimeve tjera të planifikuara për 2013, RrGGK synon që të rrisë përfshirjen e vajzave aktiviste, duke ua dhënë mundësinë që të shprehin brengat dhe nevojat e tyre. Gjatë takimeve, vajzat diskutuan problemet me të cilat ballafaqohen në jetën e përditshme: vajzat ende nuk mund të vazhdojnë arsimimin e tyre, derisa djemtë nuk ballafaqohen me këtë problem; ato nuk kanë hapësirë për të folur, sepse shoqëria mendon se prioriteti i tyre si femra duhet të jetë që të martohen dhe të rrisin fëmijë; dhe udhëheqësit e OJQ-ve dhe të politikës nuk i shohin vajzat si me mjaft përvojë ose si kandidatë të mundshme për pozita vendim-marrëse. Shumë vajza besojnë se hapi i parë për t'i tejkaluar këto probleme është që të ngritet vetëdija për të drejtat e femrave në mesin e vajzave, burrave dhe gjeneratave më të moshuara.

Këto takime fillestare ishin hapi i parë në përpjekjet më të gjëra të RrGGK për të mobilizuar më shumë vajza që të përfshihen në lëvizjen e grave, sidomos jashtë Prishtinës.

"Kam marrë pjesë në shumë trajnime për vajza dhe kam pritë që ky takim të jetë i njejtë," tha një vajzë. "Por tash që jam këtu, më të vërtetë më është dukë shumë i dobishëm dhe interesant. Nuk u lodha së dëgjuari." Vajzat u inkurajuan që të vazhdojnë të mendojnë për ide dhe zgjedhje për t'i zgjidhë problemet me të cilat ballafaqohen. Idetë e tyre do të diskutohen gjatë takimeve tjera me RrGGK vitin e ardhshëm.

Kjo nismë ka marrë përkrahje nga Kvinna till Kvinna dhe Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut.



*Vajzat diskutojnë çshtjet me të cilat ballafaqohen dhe strategjitë për t'i përballuar këto çështje gjatë një takimi konsultativ me RrGGK në Gjilan më 20 nëntor.*